



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E MBROJTJES
KOMISIONI QENDROR I STATUSIT “DËSHMOR I ATDHEUT”
KRYETARI

Nr. 143 prot

Tiranë, më 19 . 07 .2024

UDHËZIM

Nr. 143 , datë 19 . 07 .2024

PËR

**MIRATIMIN E FORMATIT TË KËRKESËS, LLOJET E DOKUMENTEVE QË
PARAQITEN PËR SHPALLJEN OSE NJOHJEN E STATUSIT “DËSHMOR I
ATDHEUT”, SI DHE KUSHTET TEKNIKE TË PLOTËSIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”,

U D H Ë Z O J:

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i formatit të kërkesës, llojet e dokumenteve që duhet të paraqiten për statusin “Dëshmor i atdheut” dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre.
2. Ky udhëzim ka për qëllim unifikimin e dokumentacionin që duhet të paraqitet, për statusin “Dëshmor i atdheut”, të cilat do të shqyrtohen nga komisionet vendore pranë këshillave të qarqeve, këshillave bashkiakë dhe prefektëve, si dhe Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Neni 2

Subjekti i udhëzimit

1. Subjekti i këtij udhëzimi është:

- a) Personi për të cilin kërkohet të shpallet “Dëshmor i atdheut” ose t’i njihet statusi “Dëshmor i atdheut”;
- b) Këshillat e qarqeve, këshillat bashkiakë, prefektët dhe komisionet vendore që funksionojnë pranë secilit prej këtyre organeve me detyrën e shqyrtimit të kërkesave për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”;
- c) Përfaqësuesi i familjes së personit, për të cilin kërkohet që të shpallet “Dëshmor i atdheut” dhe përfaqësuesi i familjes së personit të shpallur “dëshmor” nga organet shtetërore, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04. 2000 “Statusi i dëshmorit të atdheut”, të ndryshuar, për të cilin kërkohet njohja e statusit “Dëshmor i atdheut”;
- ç) Drejtuesi apo përfaqësuesi i autorizuar i organit shtetëror qendror apo vendor, në rolin e subjektit kërkues, i cili kërkon që një person të shpallet “Dëshmor i atdheut” ose t’i njihet statusi “Dëshmor i atdheut”;
- d) Përfaqësuesi i autorizuar i organizatës së dëshmorëve të atdheut, në rolin e subjektit kërkues, i cili kërkon që një person të shpallet “Dëshmor i atdheut” ose t’i njihet statusi “Dëshmor i atdheut”;
- dh) Përfaqësuesi i autorizuar i shoqërisë civile, në rolin e subjektit kërkuese, i cili kërkon që një person të shpallet “Dëshmor i atdheut” ose t’i njihet statusi “Dëshmor i atdheut”;
- e) Deputeti, në rolin e subjektit kërkues, i cili kërkon që një person të shpallet “Dëshmor i atdheut” ose t’i njihet statusi “Dëshmor i atdheut”;
- ë) Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” dhe stafi teknik në mbështetje të veprimtarisë së komisionit qendror.

Neni 3

Përkufizime

Termat e mëposhtëm, për efekt zbatimi në këtë udhëzim, kanë këto kuptime:

1. “Autoritet publik”, kuptohet çdo organ i administratës shtetërore dhe i enteve publike.

2. “Bie” kuptohet kur një person vritet a vdes (jep jetën) për një çështje të drejtë, duke luftuar në një betejë, në fushën e nderit.
3. “Burime dytësore” janë dokumentet të cilat citojnë apo komentojnë burimet parësore dhe ndihmojnë në plotësimin e mangësive që vjen nga mospasja e dokumenteve të prodhuara nga organet publike të kohës.
4. “Dëshmor i atdheut” kuptohet personi i ndarë nga jeta, i cili është shpallur “Dëshmor i atdheut” me dekret apo vendim të organeve shtetërore.
5. “Dokumente shoqëruese” kuptohen dokumentet që i bashkëlidhen kërkesës së paraqitur pranë këshillit të qarkut ose këshillit bashkiak apo prefektit të qarkut, që vërtetojnë objektin e kërkesës.
6. “Dokument zyrtar” kuptohet dokumenti i çdo lloji, i mbajtur (krijuar) nga organet publike, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që kanë lidhje me ushtrimin e një funksioni publik.
7. “Dokumente të burimeve parësore” janë dokumente zyrtare origjinale që janë krijuar nga organet publike në kohën e ngjarjes objekt shqyrtimi, me të dhëna (informacion) për rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së personit, që është objekt vlerësimi nga strukturat e ngarkuara nga ligji për statusin e dëshmorit të atdheut.
8. “Dokumente me burime arkivore të referuara qartë” kuptohen dokumente dalë nga arkivi shtetëror apo privat, i cili është regjistruar në inventarin e fondeve të fondkrijuesit dhe detyrimisht përmban të shkruar qartë dhe në formë të kuptueshme referencat e regjistrimit të tij.
9. “Dokumente provuese” është akti shkresor i një institucioni publik, privat apo akt i përgatitur nga vetë kërkuesi, që provon përmbushjen e një kushti për shpalljen “Dëshmor të atdheut” të një personi apo njohjen e statusit “Dëshmor të atdheut” të një personi të shpallur “dëshmor” nga organet shtetërore para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04. 2000 “Statusi i dëshmorit të atdheut”, të ndryshuar”.
10. “Familje e dëshmorit të atdheut” është familja me shtetësi shqiptare ose shtetësi të huaj që i ka dhënë Shqipërisë një apo më shumë persona të shpallur “Dëshmor të atdheut”, me dekrete dhe vendime nga organet shtetërore shqiptare.
11. “Fatkeqësi natyrore” kuptohen: tërmetet, përmbytjet, thatësirat atmosferike të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta, zjarret në pyje dhe në mjediset e banuara, sëmundjet infektive masive, pasojat e të cilave prekin popullatën, gjënë e gjallë, pronën mjedisore, si dhe ngjarje të tjera të shkaktuara nga dukuri të tjera.

12. “Njohje e statusit “Dëshmor i atdheut” është vendimi i Komisionit Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” që njih dekreten ose vendimin e dhënë nga organi shtetëror për shpalljen “dëshmor”, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04. 2000 “Statusi i dëshmorit të atdheut”, të ndryshuar”, i cili është shfuqizuar nga ligji nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.
13. “Humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës” janë rastet që ndodhin, gjatë kohës së detyrës apo shërbimit, kur ngjarja ka ndodhur për arsye që lidhen me detyrën ose jashtë kohës së detyrës apo shërbimit, kur shkak për ndodhjen e ngjarjes janë veprimet e ligjshme të punonjësit në kryerjen e detyrës. Rrethanat e mësipërme duhet të vërtetohen nga organet e drejtësisë, gjykatat, si dhe ministritë përkatës, sipas juridiksionit të tyre.
14. “Humb jetën”, nuk është në jetë, vdes.
15. “Ka rënë” kuptohet veprimi kur personi për të cilin kërkohet dhe propozohet për t’u shpallur dëshmor i atdheut, i cili ka kryer një akt vetëmohimi me vullnet të plotë, pa kursyer edhe jetën e tij, në mbrojtje të interesave të shtetit, të mirësisë publike ose jetës së personit. Ata që janë vrarë në luftë a betejë.
16. “Kërkesë” kuptohet një veprim që i drejtohet me shkrim një organi shtetëror të ngarkuar nga ligji për statusin e dëshmorit të atdheut për të zhvilluar procedurat për statusin e “Dëshmorit të atdheut”.
17. “Kritere” për shpalljen apo njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” është ajo pjesë e kushteve të përcaktuara në nenin 5 të ligjit për statusin e “Dëshmorit të atdheut”, që kërkohen të përmbushen.
18. “Mbetje mortore” janë eshtrat dhe /ose hiri i kufomës të dëshmorit të atdheut, pas djegies së trupit të tij.
19. “Ministër propozues”, në kuptimin e këtij udhëzimi, është ministri që ka filluar procedurat për propozimin për shpalljen dëshmor të atdheut të një personi (subjekti) në vartësinë komanduese të tij dhe, pasi ka marrë vlerësimin paraprak të strukturës vartëse, e dërgon propozimin për shqyrtim në Komisionin Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”.
20. “Organe publike” kuptohen organet përfaqësuese të pushtetit qendror dhe vendor të çdo periudhe, institucionet e administratës qendrore dhe vendore të çdo periudhe, organet kushtetuese, personat juridikë dhe fizikë, në masën që ata përmbushin funksionet publike ose ushtrojnë një detyrë administrative, sipas ligjeve në fuqi të kohës.
21. “Organe shtetërore përpara hyrjes në fuqi në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04.2000 “Statusi i dëshmorit të atdheut”, të ndryshuar”, janë: ish-Komiteti Ekzekutiv i Këshillit

Popullor të Rrethit, Ish-Këshilli Ekzekutiv Pluralist i Rrethit, Këshilli Bashkiak, Kuvendi Popullor dhe Kryesia e Këshillit të Ministrave.

22. “Palë e interesuar” në një procedurë administrative do të quhet një person fizik, juridik ose autoritet shtetëror, të drejtat apo kompetencat e ligjshme të të cilit qofshin këto individuale ose të përbashkëta kanë të ngjarë të prekin gjatë procedurës administrative.
23. “Pension familjar” kuptohet pensioni (shpërblimi financiar) që i është lidhur (dhënë) ndonjërit prej pjesëtarëve të familjes së personit të shpallur “Dëshmor i atdheut” nga organet shtetërore të kohës.
24. “Person” është personi fizik me shtetësi shqiptare, shtetësi i huaj ose pa shtetësi që ka jetuar e ka vepruar para datës së krijimit të shtetit shqiptar (28 nëntor 1912).
25. “Përfaqësues i familjes” kuptohet çdo person fizik apo juridik, i caktuar me dokument (dëshmi noteriale) nga familja e personit për të cilin kërkohet dhënia e statusi “Dëshmor i atdheut”.
26. “Rivarrim” është vendosja e kufomës dhe /ose mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut që prehen në varrezat publike në Varrezën e Dëshmorëve të Atdheut.
27. “Rrezik” kuptohet një gjendje serioze, reale dhe e menjëhershme, që kanos jetën e njerëzve, të gjësë së gjallë, dëmtimin e pronës publike, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit që mund të shkaktohet nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësi të tjera.
28. “Rrethi i ngushtë familjar”, në kuptimin e këtij udhëzimi, janë pjesëtarët: bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët nën moshën 18 vjeç ose deri 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari.
29. “Subjekte kërkuese” kuptohet përfaqësuesi i familjes së personit, për të cilin kërkohet që të shpallet “Dëshmor i atdheut”, përfaqësuesi i familjes së dëshmorit për të cilin kërkohet t’i njihet statusi “Dëshmor i atdheut”; drejtuesi i organit shtetëror; drejtuesi i organizatës së dëshmorëve të atdheut, si dhe përfaqësuesi i shoqërisë civile, të cilët kërkojnë që një person të shpallet “Dëshmor i atdheut” apo t’i njihet statusi “Dëshmor i atdheut”, i shpallur me dekret apo vendim të një organi shtetëror, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04. 2000 “Statusi i dëshmorit të atdheut”, të ndryshuar”.
30. “Subjekte propozuese” janë: këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, prefekti dhe ministri në fushën e përgjegjësisë së të cili lidhet aktiviteti i personit që bie, vritet apo humb jetën në krye të detyrës dhe për shkak të detyrës dhe që propozohet për t’u shpallur “Dëshmor i atdheut”.
31. “Shërbimi i varrimit” është veprimtaria që zhvillohet nga subjektet publike, nga çasti i vdekjes deri në varrimin e kufomës dhe /ose mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut.

32. “Shpallje” është vendimi i Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut, që i jep personit të propozuar statusin “Dëshmor i atdheut”.
33. “Shtetas” është pjesëtar i popullsisë së përhershme të një shteti, i cili gëzon të gjitha të drejtat civile dhe publike, si dhe përmbush të gjitha detyrat që i takojnë sipas ligjeve të këtij shteti.
34. “Varrim” është procesi i varrosjes në varr të kufomës dhe /ose mbetjeve mortore që i bëhen dëshmorit të atdheut.
35. “Varrezë e dëshmorëve të atdheut” është një parcelë e hapur (e përcaktuar) territori (tokë) ku varrosen dëshmoret e atdheut, e cila është ndërtuar, meremetohet dhe ruhet nga shteti sipas proceduarave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.
36. “Vdekje” është ndalimi i veprimtarisë jetësore të organizmit të njeriut.
37. “Viktimë” ai që vritet a plagoset në një aksident, që vdes a dëmtohet nga tërmeti, nga përmytja etj., ai që vritet a plagoset ose pëson pa të drejtë një të keqe të madhe nga dikush.
38. “Zhvarrim është nxjerrja e kufomës dhe/ose mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut nga vendi i prehjes.
39. “Institucion i ruajtjes së kujtesës” është ai institucion qendror apo vendor që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme dhe të paluajtshme, në funksion të ruajtjes së kujtesës në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimi të saj.

KREU II

OBJEKTET E KËRKESËS PËR STATUSIN “DËSHMOR I ATDHEUT” DHE ORGANET QË IU DREJTOHEN

Neni 4

Objektet e kërkesës

Kërkesa për statusin e “Dëshmorit të atdheut” mund të ketë si objekt të saj:

- a) njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” të një personi të shpallur “dëshmor” me dekrete apo vendime të organeve shtetërore, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04. 2000 “Statusi i dëshmorit të atdheut”, të ndryshuar”;
- b) shpalljen “Dëshmor të atdheut” të një personi që ka humbur jetën;

- c) rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut në varrezën e dëshmorëve të atdheut “Nëna Shqipëri”, në kryeqytet apo varrezën e dëshmorëve të atdheut të rrethit (qarkut);
- ç) marrjen e masave për mirëmbajtjen e varrezave të dëshmoreve të atdheut, të lapidarëve të dëshmorëve, busteve, pllakave përkujtimore, si dhe çdo kërkesë tjetër në lidhje me dëshmorët e atdheut; bazuar në ligjin nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.
- d) ankesë kundër vendimit të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit, që refuzon të pranojë kërkesën ose kur këto organe nuk marrin në shqyrtim kërkesën brenda afatit të përcaktuar nga ligji nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.

Neni 5

Organet ku paraqitet kërkesa

1. Kërkesa, së bashku me dokumentet me karakter të përgjithshëm dhe dokumentet vërtetuese, sipas këtij udhëzimi, me objekt sipas pikave të nenit 5, të ligjit nr.109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, dërgohet nëpërmjet portalit e-Albania nga “subjekti kërkuar” pranë komisioneve vendore për shqyrtimin e kërkesave për shpalljen apo njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, të ngritura pranë këshillave bashkiakë, këshillave të qarqeve ose prefektëve, ku ka vendbanimin familja e personit që kërkohet të shpallet ose të njihet si “Dëshmor i atdheut”.
2. Kërkesa për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të një personi që plotëson kriteret sipas shkronjave “g”, “h”, “i”, “j”, “l”, “nj”, “o”, “e” dhe “p”, të nenit 5, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, i drejtohet edhe ministrit nëpërmjet portalit e-Albania, në fushën e përgjegjësisë së të cilit lidhet aktiviteti shoqëror i personit që kërkohet të shpallet “Dëshmor i atdheut”.
3. Kërkesë-ankesa kundër vendimit të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit, që refuzon të pranojë kërkesën ose kur këto organe nuk marrin në shqyrtim kërkesën brenda afatit të përcaktuar nga ligji nr.109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut” dërgohet nëpërmjet portalit e-Albania pranë stafit teknik të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

KREU III

SUBJEKTET KËRKUESE QË PARAQESIN KËRKESËN PËR STATUSIN E “DËSHMORIT TË ATDHEUT” DHE FORMATI I KËRKESËS

Neni 6

Subjektet kërkuese që paraqesin kërkesën

1. Kërkesa për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” të personit të shpallur “Dëshmor” nga organe shtetërore përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04. 2000 “Statusi i dëshmorit të atdheut”, të shfuqizuar”, mund të paraqitet nga:
 - a) përfaqësues i familjes së personit, për të cilin kërkohet që të shpallet ose t’i njihet statusi “Dëshmor i atdheut”;
 - b) përfaqësues të autorizuar të organeve shtetërore qendrore dhe vendore;
 - c) përfaqësues të autorizuar të organizatave të dëshmorëve të atdheut;
 - ç) përfaqësues të autorizuar të shoqërisë civile.
 - d) deputetë.
2. Kërkesën në emër të familjes së personit, për të cilin kërkohet shpallja ose njohja e statusit “Dëshmor i atdheut”, paraqitet nga pjesëtari i autorizuar i familjes të personit objekt shqyrtimi sipas kësaj radhe: bashkëshortja/bashkëshorti, fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, nipat dhe bashkëlidhur me formatin e kërkesës së plotësuar prej tyre, sipas formatit (shtojca 1), duhet dorëzuar dhe prokurë e posaçme apo deklaram noteriale të përfaqësimit të lëshuar nga të gjithë pjesëtarët e rrethit të ngushtë të familjes.
3. Kur kërkesa për shpalljen apo njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” të një personi bëhet nga përfaqësues të autorizuar të organizatave të dëshmorëve të atdheut, shoqërisë civile apo nga një deputet, bashkëlidhur me formatin e kërkesës së plotësuar prej tyre, sipas formatit (shtojca 1), bashkëlidhur këtij udhëzimi, duhen dërguar dhe dokumente, që vërtetojnë aprovimin e rrethit të ngushtë të familjes së të ndjerit për të cilin kërkohet të shpallet “Dëshmor i atdheut” apo për t’i njohur statusin “Dëshmor i atdheut”.

Neni 7

Formati i kërkesës

1. Format i kërkesës është sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Dokumentet bashkëlidhur kërkesës, sipas formatit (shtojca 1) të këtij udhëzimi, duhet të jenë sipas neneve të kreut IV të këtij udhëzimi.

KREU IV

DOKUMENTET SHOQËRUESE TË FORMATIT TË KËRKESËS PËR STATUSIN “DËSHMOR I ATDHEUT”

Neni 8

Dokumente vërtetuese të kërkesës të karakterit të përgjithshëm

Dokumente të karakterit të përgjithshëm që shoqërojnë gjithnjë dhe për çdo rast (objekt) kërkesën e plotësuar nga subjekti kërkuar, sipas formatit (shtojca 1) bashkëlidhur këtij udhëzimi, janë:

1. Prokurë e posaçme ose deklaratë noteriale, që vërteton se “subjekti kërkuar” është autorizuar për kryerjen e veprimeve dhe ndjekjen e procedurave për statusin e dëshmorit të atdheut nga pjesëtarët e familjes së personit objekt të kërkesës.
2. Certifikatë familjare që vërteton lidhjen familjare të subjektit kërkuar me personin objekt të kërkesës.
3. Autorizimi i përfaqësimit të firmosur dhe të vulosur nga drejtuesit e organit shtetëror apo të organizatave të dëshmorëve të atdheut apo organizatave të veteranëve të LANÇ-it, kur subjekti kërkuar për statusin e dëshmorit të atdheut është përfaqësues i autorizuar i këtyre subjekteve.
4. Dokumentin e statusit dhe të vendimit të regjistrimit në gjykatë të organizatës jofitimprurëse, kur subjekti kërkuar për statusin e dëshmorit të atdheut është përfaqësues i autorizuar i shoqërisë civile (organizatë joqeveritare me qëllime jofitimprurëse).
5. Fotokopje të dokumentit (kartës së deputetit), si dhe kartën e identitetit që vërteton se subjekti kërkuar ushtron funksionin e deputetit, kur subjekti kërkuar është deputet.
6. Certifikatë vdekjeje ose “certifikatë negative” të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, në juridiksionin territorial të vendbanimit të përhershëm të personit apo shtetasit objekt të kërkesës dhe në rastin e personit apo shtetasit të huaj, certifikatë vdekjeje nga institucionet përgjegjëse të shtetit amë.
7. Certifikatë e përbërjes familjare (trungut familjar) në çastin e ndarjes nga jeta të personit në rastin e personit apo shtetasit të huaj, certifikatë e përbërjes familjare nga institucionet përgjegjëse të shtetit amë.
8. Vërtetim nga institucionet përgjegjëse për vendin e varrimit për shtetasin shqiptar dhe të huaj objekt të kërkesës.
9. Fotografë ose çfarëdo dokumenti me figurë të personit për të cilin kërkohet njohja e statusit “Dëshmor i atdheut”.
10. Dokumente shoqëruese të medaljeve dhe titujve të nderit dhëna nga institucionet shtetërore (në rast se administrohet nga familja).

Neni 9

Dokumentet për njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” për shtetasit shqiptarë dhe të huaj të shpallur “dëshmorë” nga organet shtetërore, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04. 2000 “Statusi i dëshmorit të atdheut”, të ndryshuar

Për njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të shpallur “dëshmorë” nga organet shtetërore, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04.2000 “Statusi i dëshmorit të atdheut”, të ndryshuar, bashkëlidhur me formatin e kërkesës (shtojca 1) sipas këtij udhëzimi, të plotësuar nga subjekti kërkues, si dhe të dokumenteve të karakterit të përgjithshëm të përshkruara në nenin 8 të këtij udhëzimi, duhen dorëzuar dhe dokumentet vërtetuese, si më poshtë, vijon:

1. Dekreti ose vendimi i organit shtetëror, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04. 2000 “Statusi i dëshmorit të atdheut”, të ndryshuar, që vërteton shpalljen “dëshmor” të personit objekt shqyrtimi të kërkesës.
2. Në mungesë të dokumentit zyrtar të organit shtetëror i cili e ka shpallur “dëshmor” personin, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04. 2000 “Statusi i dëshmorit të atdheut”, të ndryshuar, subjekti kërkues mund të dërgoj dokumente të tjera provuese, si:
 - a) Vërtetim negativ nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, arkivat e sistemit, si dhe nga arkivat e institucioneve qendrore dhe vendore, i cili vërteton se në këto institucione nuk gjenden dekret apo vendim i formës së shkruar nga organet shtetërore të mëparshme që vërtetojnë shpalljen “Dëshmor të atdheut” të personit për të cilin kërkohet t’i njihet statusi “Dëshmor i atdheut”.
 - b) Dokumente nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, arkivat e sistemit, si dhe nga arkivat e institucioneve qendrore dhe vendore, ku jepen informacione apo të dhëna për shpalljen “dëshmor” të personit nga organet shtetërore, **përpara** hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04. 2000 “Statusi i dëshmorit të atdheut”, të ndryshuar.
 - c) Dokumenti “Kartela e dëshmorit” e arkivuar dhe e lëshuar nga Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të Atdheut të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe Dëshmorëve të Tjerë të Atdheut (në shkallë vendi) apo Dega e Organizatës së Dëshmorëve të Atdheut të Rrethit (në shkallë qarku), që vërteton regjistrimin e personit si “dëshmor”
 - ç) Fotokopje e dokumentit “Librezë e Triskës” për familjen e dëshmorit, të lëshuar nga ish-Drejtoria e Mbrojtjes Sociale në vitin 1945-1969.
 - d) Vërtetim për dhënien apo shpërblimin pensioni si familje “Dëshmorit të LANÇL-it”, të lëshuar nga Ish-Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Qarkut (Seksioni financës) në vitin 1945-1969.

dh) Vërtetim për dhënie “pensionit” si familje e “Dëshmorit të LANÇL-it” nga dekreti nr. 17635, datë 05.03.1954 “Për shpërblimin e dëshmorit të atdheut”.

e) Vërtetim nga muzeu i bashkisë apo qarkut që vërteton se personi është shpallur apo është regjistruar si dëshmor i atdheut (në këto dokumente duhet të ketë referenca të qarta e të plota për shpalljen “dëshmor”).

ë) Vërtetim nga strukturat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që vërteton se familja e personit që konsiderohet “dëshmor” ka përfituar shpërblimit financiar si familje e dëshmorit të atdheut (fotokopje të librezës së pensionit që vërteton se ka fituar shpërblim financiar).

Neni 10

Dokumentet për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të personit me veprimtari para datës 28 nëntor 1912 dhe dokumentet për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të shtetasit shqiptar dhe të huaj me veprimtari nga data 28 nëntor 1912 deri më 7 prill 1939

Për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të personit me veprimtari para datës 28 nëntor 1912 dhe për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të shtetasit shqiptar dhe të huaj me veprimtari nga data 28 nëntor 1912 deri më 7 prill 1939, bashkëlidhur me formatin e kërkesës (shtojca 1) sipas këtij udhëzimi, të plotësuar nga subjekti kërkuar, si dhe të dokumenteve të karakterit të përgjithshëm të përshkruara në nenin 8 të këtij udhëzimi, duhen paraqitur dhe dokumentet vërtetuese, si më poshtë, vijon:

1. Dokumente nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, arkivat e sistemit, si dhe nga arkivat e institucioneve qendrore dhe vendore apo arkivat e huaja, të prodhuara nga organet publike të kohës apo të organeve publike të shteteve të tjera të huaja në kohën e ngjarjes, të cilat japin të dhëna për ngjarjen historike të kohës për aktivitetin patriotik dhe për rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së personit për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”, nëse nuk administrohen këto dokumente duhet të paraqitet vërtetim negativ.
2. Dokumentacion mbështetës, të lëshuar nga institucionet e ruajtjes së kujtesës, si kopje të shtypit të shkruar shqiptar apo të huaj të kohës (gazeta, revista etj.), botime të karakterit historik, folklorik, publicistik e manuale biografike, medalje dhe tituj të nderit të dhëna nga institucionet shtetërore të cilat japin të dhëna për ngjarjen historike të kohës, si dhe për rrethanat e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar ose të huaj, për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.

Neni 11

Dokumentet për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të shtetasit shqiptar dhe të huaj me veprimtari nga data 7 prill 1939 deri më datën 9 maj 1945 (LANÇ)

Për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të shtetasit shqiptar dhe të huaj me veprimtari nga data 7 Prill 1939 deri më datën 9 Maj 1945 (LANÇ), bashkëlidhur me formatin e kërkesës (shtojca 1) sipas këtij udhëzimi, të plotësuar nga subjekti kërkues, si dhe të dokumenteve të karakterit të përgjithshëm të përshkruara në nenin 8 të këtij udhëzimi, duhen paraqitur dhe dokumentet vërtetuese, si më poshtë, vijon:

a) Për shtetasin shqiptar dhe të huaj i cili ka marrë pjesë me armë në dorë ose në formë të organizuar në LANÇ dhe ka rënë duke luftuar dhe për shtetasin shqiptar, i cili ka qenë pjesëtar i formacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, i cili ka rënë në luftë jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë deri më 9 maj 1945:

1. Duhet të paraqiten të gjithë dokumentet vërtetuese sipas nenit 10 të këtij udhëzimi, si dhe:
2. Vërtetim nga Organizata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, që vërteton se shtetasi për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut” ka marrë pjesë me armë në dorë ose në formë të organizuar në LANÇ dhe ka rënë duke luftuar ose që ka qenë pjesëtar i formacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe ka rënë duke luftuar jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë deri më 9 maj 1945.

b) Për shtetasin shqiptar i cili ka qenë pjesëmarrës në formacionet e rregullta të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, i cili ka humbur jetën brenda datës 9 maj 1947 për shkak të sëmundjeve dhe plagëve të marra ose fatkeqësive të ndryshme, duke qenë në krye të detyrës luftarake:

1. Duhet të paraqiten të gjithë dokumentet vërtetuese sipas nenit 10 të këtij udhëzimi, si dhe:
2. Dokument nga institucionet shëndetësore të kohës, si: Spitali Qendror Ushtarak apo spitali qendror shtetëror, spitali publik i rrethit, të cilët vërtetojnë shkakun (diagnozën) e ndarjes nga jeta të shtetasit shqiptar, për të cilin kërkohet dhënia e statusit “Dëshmor i atdheut”, në rast se nuk gjenden të dhëna duhet të paraqitet vërtetim negativ.

c) Për shtetasin shqiptar i cili është ekzekutuar ose ka vdekur në burgjet dhe kampet e përqendrimit nazifashist apo ka vdekur si pasojë e plagëve apo sëmundjeve të ndryshme të marra në këto vende deri më 9 maj 1947:

1. Duhet të paraqiten të gjithë dokumentet vërtetuese sipas nenit 10 sipas këtij udhëzimi, si dhe:
2. Dokumente nga institucionet shëndetësore të kohës, si: Spitali Qendror Ushtarak apo spitali qendror shtetëror, spitali publik i rrethit, të cilët vërtetojnë shkakun e ndarjes nga jeta të shtetasit shqiptar, për të cilin kërkohet dhënia e statusit “Dëshmor i atdheut” (nëse shtetasi shqiptar është kthyer nga burgjet dhe kampet e përqendrimit nazifashist

dhe ka vdekur brenda vendit deri më 9 maj 1947), në rast se nuk gjenden të dhëna duhet të paraqitet vërtetim negativ.

3. Dokumente nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, arkivat e sistemit, si dhe nga arkivat e institucioneve qendrore dhe vendore, **kryqi i kuq ose arkivat e shteteve të huaja**, ku ishin ndërtuar dhe funksiononin burgjet dhe kampet e përqendrimit nazifashiste, ku të vërtetohet burgosja dhe internimi në kampet e përqendrimit, brenda dhe jashtë vendit, si dhe periudha e burgosjes dhe e ndarjes nga jeta në këto vende, të shtetasit shqiptar, për të cilin kërkohet dhënia e statusit “Dëshmor i atdheut”.

ç) Për shtetasin shqiptar i cili është pushkatuar për pjesëmarrjen në formacionet luftarake të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare apo për mbështetje të pjesëmarrësve të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, si dhe të pushkatuar për hakmarrje nga pushtuesit nazifashistë dhe bashkëpunëtorët e tyre nga data 7 prill 1939 deri më 29 nëntor 1944:

1. Duhet të paraqiten të gjithë dokumentet vërtetuese sipas nenit 10 të këtij udhëzimi, si dhe:
2. Dokumente nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, arkivat e sistemit, si dhe nga arkivat e institucioneve qendrore dhe vendore, të prodhuara nga organet publike të shtetit shqiptar, në kohën e ngjarjes, të cilat japin të dhëna për ngjarjen historike të kohës, për pjesëmarrjen e personit objekt të kërkesës në formacionet luftarake të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare apo në mbështetje të pjesëmarrësve të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, si për rrethanat dhe kohën e pushkatimit për hakmarrje nga pushtuesit nazifashistë apo bashkëpunëtorët e tyre.
3. Vërtetim nga organizatat e veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, që vërteton se personi objekt i kërkesës ka qenë pjesëtar i formacioneve luftarake të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare apo në mbështetje të pjesëmarrësve të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, si dhe është pushkatuar për hakmarrje nga pushtuesit nazifashistë apo bashkëpunëtorët e tyre.

dh) Për shtetasit shqiptarë pjesëmarrës në formacionet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare që janë ekzekutuar me vendime të gjyqeve partizane për shkelje të moralit partizan dhe më vonë ka rezultuar që gjykimi ka qenë i pa mbështetur në prova:

1. Duhet të paraqiten të gjithë dokumentet vërtetuese sipas nenit 10 sipas këtij udhëzimi, si dhe:
2. Dokumente nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, arkivat e sistemit, si dhe nga arkivat e institucioneve qendrore dhe vendore, të prodhuara nga organet publike të shtetit shqiptar, në kohën e ngjarjes, të cilat japin të dhëna për pjesëmarrjen e personit objekt të kërkesës, në formacionin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, për

akuzat ndaj tij/saj për shkeljen e moralit partizan, si dhe rrethanat e ekzekutimit (pushkatimit) nga gjyqi partizan.

3. Dokumente arkivore të prodhuara nga organet publike të pas çlirimit të vendit nga pushtuesin nazifashistë, të cilat japin të dhëna që akuza për shkeljen e moralit partizan nga personi objekt i kërkesës, gjykimi dhe vendimi për ekzekutim e tij/saj nga gjyqi partizan ka qenë i pambështetur në fakte dhe në prova.
4. Vërtetim nga organizatat e veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, që vërteton se personi për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut” dhe familja e tij nuk ka bashkëpunuar me pushtuesit e vendit gjatë periudhës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe se akuzat për shkeljen e moralit partizan dhe ekzekutimi i tij/saj nga gjyqi partizan apo forcat partizane ka qenë i pambështetur në fakte dhe prova.

e) Për shtetasit e huaj pjesëtarë të formacioneve të ushtrive aleate në Luftën e Dytë Botërore, në ndihmë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, të cilët kanë humbur jetën brenda territorit të Shqipërisë:

1. Duhet të paraqiten të gjithë dokumentet vërtetuese sipas nenit 10 të këtij udhëzimi, si dhe:
2. Dokumente nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, arkivat e sistemit, si dhe nga arkivat e institucioneve qendrore dhe vendore, të prodhuara nga organet publike të shtetit shqiptar apo të organeve publike të shteteve të huaja, në kohën e ngjarjes, të cilat japin të dhëna për ngjarjen historike të kohës, formacionin luftarak të ushtrisë aleate në Luftën e Dytë Botërore ku ishte pjesëtar ushtaraku i huaj, në ndihmë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, si dhe për rrethanat e humbjes së jetës brenda territorit të Shqipërisë së ushtarakut të huaj, për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.
3. Dokumente nga arkivat e ushtarakut të shtetit amë të shtetasit të huaj objekt i kërkesës, të cilat japin të dhëna për ngjarjen historike të kohës, si dhe për rrethanat e humbjes së jetës brenda territorit të Shqipërisë të ushtarakëve të huaj, për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.
4. Faksimileve të shtypit shqiptar apo të huaj të kohës dhe të sotme (gazeta, revista etj.), që japin të dhëna dhe informacion për ngjarjen historike të kohës, si dhe për rrethanat e humbjes së jetës brenda territorit të Shqipërisë së ushtarakëve të huaj, për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.
5. Fotokopje të botimeve të karakterit historik, folklorik, publicistik e manuale biografike, të publikuara brenda dhe jashtë vendit.

6. Vërtetim nga organizatat e veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, që japin të dhëna dhe informacion për ngjarjen historike të kohës, formacionin luftarak të ushtrisë aleate në Luftën e Dytë Botërore, në ndihmë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, ku ishte pjesëtar ushtaraku i huaj, si dhe për rrethanat e humbjes së jetës brenda territorit të Shqipërisë të ushtarakëve të huaj, për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.

Neni 12

Dokumentet për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të shtetasit shqiptar që ka rënë në luftë për pavarësinë e Kosovës dhe për të drejtat kombëtare në konfliktet e tjera etnike të zhvilluara në Ballkan

Për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të shtetasit shqiptar që ka rënë në luftë për pavarësinë e Kosovës dhe për të drejtat kombëtare në konfliktet e tjera etnike të zhvilluara në Ballkan, përveç formatit të kërkesës (shtojca nr.1), të plotësuar nga subjekti kërkues dhe dokumenteve të karakterit të përgjithshëm të përshkruara në nenin 8 të këtij udhëzimi, duhet të paraqiten dhe dokumente vërtetuese, si më poshtë:

1. Certifikata e gjendjes gjyqësore e shtetasit që kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.
2. Vërtetim nga Komanda e Trupës Mbështetëse të Kosovës, i cili duhet të përmbajë: identitetin e plotë dhe të saktë të të ndjerit, njësinë ose repartin e UÇK-së, UÇBM-së apo struktura të tjera politike-ushtarake, ku ka marrë pjesë, vendin dhe kohën e rënies në krye të detyrës luftarake etj.
3. “Certifikatë e Dëshmorit të Kombit”, të lëshuar nga Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Internuarit të UÇK-së të Republikës së Kosovës apo nga shtetet e tjera ballkanike, ku ka rënë i ndjeri.
4. Vendim i pensionit të skemës “Familje e Dëshmorit të Kombit”, të lëshuar nga institucionet shtetërore të shtetit përkatës.
5. Vërtetim nga Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së, Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së dhe Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së.
6. Vërtetim nga organet e pushteti vendor të Republikës së Shqipërisë, ku ka pasur gjendjen civile shtetasi shqiptar që ka humbur jetën në luftën për pavarësinë e Kosovës dhe për të drejtat kombëtare në konfliktet e tjera etnike të zhvilluara në Ballkan, që vërtetojnë pjesëmarrjen dhe kontributin e të ndjerit, në luftën për pavarësinë e Kosovës, si dhe drejtat kombëtare në konfliktet e tjera në Ballkan.

7. Dokumente nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut, si dhe Komisariati i Policisë, që ka pasur në juridiksion vendbanimin e të ndjerit, që japin të dhëna, për datën dhe vendin, si dhe rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës brenda territorit të Republikës së Shqipërisë së shtetasit shqiptar, që ka humbur jetën në luftë për pavarësinë e Kosovës dhe për të drejtat kombëtare në konfliktet e tjera etnike të zhvilluara në Ballkan (vetëm për personin që ka humbur jetën brenda territorit të Republikës së Shqipërisë).
8. Dokumente nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor që ka pasur në juridiksion vendbanimin e të ndjerit, që jep të dhëna, për hetimin e ngjarjes së vdekjes së shtetasit shqiptar që ka humbur jetën në luftë për pavarësinë e Kosovës dhe për të drejtat kombëtare në konfliktet e tjera etnike të zhvilluara në Ballkan (vetëm për personin që ka humbur jetën brenda territorit të Republikës së Shqipërisë).
9. Dokumenti Aktekspertiza e vdekjes së shtetasit shqiptar, të lëshuar nga spitali i shtetëror rajonal apo Shërbimi i Ekspertizës Mjekoligjore.
10. Çdo dokument tjetër zyrtar, që jep të dhëna për pjesëmarrjen e shtetasit shqiptar, në luftën për çlirimin e Kosovës nga pushtuesit serb apo në konfliktet e tjera ballkanike.

Neni 13

Dokumentet për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të shtetasit shqiptar apo të huaj që ka rënë/ humbur jetën gjatë periudhës 29 nëntor 1944 e në vazhdim.

Për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të shtetasit shqiptar apo shtetasit të huaj që ka rënë apo ka humbur jetën në krye të detyrës dhe për shkak të detyrës **gjatë periudhës 29 nëntor 1944 e në vazhdim**, bashkëlidhur me formatin e kërkesës (shtojca 1), sipas këtij udhëzimi, të plotësuar nga subjekti kërkues, si dhe të dokumenteve të karakterit të përgjithshëm të përshkruara në nenin 8 të këtij udhëzimi, duhen paraqitur dhe dokumentet vërtetuese, si më poshtë vijon:

a) Kur shtetasi shqiptar ka qenë ish-ushtarak apo punonjës civil i strukturave të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes dhe ka humbur jetën në krye të detyrës dhe për shkak të detyrës:

1. Certifikata e gjendjes gjyqësore për personin për të cilin kërkohet të shpallet “Dëshmor i atdheut”.
2. Dokumentet me të dhëna dhe informacion që ndodhen në regjistrat e rekrutimit dhe në dosjet personale të ish-ushtarakut/punonjësit civil, të arkivuar pranë Qendrës Personel-Rekrutimit të Forcave të Armatosura.

3. Dokumente nga Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura të prodhuara nga strukturat e Forcave të Armatosura (komanda e ish-repartit ushtarak, drejtoritë e Shtabit të Përgjithshëm i FA-së dhe ministrisë së Mbrojtjes, strukturave të Policisë Ushtarake, SHIU, etj), në kohën e humbjes së jetës së ish-ushtarakut/punonjësit civil, për të cilin kërkohet shpallja dëshmor i atdheut, që të vërtetojnë se ish-ushtaraku ka humbur jetën në krye të detyrës dhe për shkak të detyrës.
4. Informacion nga dosja hetimore e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e juridiksionit ku ka ndodhur ngjarja e humbjes së jetës së ish-ushtarakut/punonjësit civil, për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.
5. Aktekspertiza e vdekjes ish-ushtarakut apo punonjës i FA-së, të lëshuar nga ish-Spitali Qendror Ushtarak; Spitali Universitar i Traumës; apo spitali shtetëror rajonal ose Shërbimi i Ekspertizës Mjekoligjore.
6. Vendimi i gjykatës së formës së prerë që jep të dhëna për rrethanat dhe shkaqet e ndarjes nga jeta të ish-ushtarakut për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.
7. Dokument nga Ministria e Mbrojtjes apo Shtabi i Përgjithshëm, që të shprehet për rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së ish-ushtarakut dhe prononcimin e këtij institucioni se vdekja e ish-ushtarakut apo punonjësit civil ka qenë në krye të detyrës dhe ka ardhur për shkak të detyrës ose jo.

b) Kur shtetasi shqiptar ka qenë punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme dhe kanë humbur jetën në krye të detyrës dhe për shkak të detyrës:

1. Certifikatë e gjendjes gjyqësore për personin për të cilin kërkohet të shpallet “Dëshmor i atdheut”.
2. Vërtetim që ka kryer shërbimin ushtarak nga Qendra e Personel-Rekrutimit të Forcave të Armatosura në rastet e shërbimit ushtarak të detyrueshëm.
3. Dokumente dhe informacione nxjerra nga dosja personale e ish-ushtarakut/punonjësit civil, të arkivuar pranë Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme.
4. Dokumente nga arkivi i sistemit të Ministrisë së Brendshme, të arkivuara në kohën e humbjes së jetës së ish-punonjësit të Policisë së Shtetit, për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”, që vërtetojnë se punonjësi ka humbur jetën në krye të detyrës dhe për shkak të detyrës.
5. Dokumente nga dosja hetimore e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e juridiksionit ku ka ndodhur ngjarja e humbjes së jetës së ish-punonjësit të Policisë së Shtetit, për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.

6. Aktekspertiza e vdekjes së ish-punonjësit të Policisë së Shtetit, të lëshuar nga ish-Spitali Qendror Ushtarak; Spitali Universitar i Traumës; apo spitali shtetëror rajonal ose Shërbimi i Ekspertizës Mjekoligjore.
 7. Vendimi i gjykatës së formës së prerë që jep të dhëna për rrethanat dhe shkaqet e ndarjes nga jeta të ish-punonjësit të Policisë së Shtetit për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.
 8. Dokument nga Drejtoria e Menaxhimit të Personelit në Ministrinë e Brendshme që shprehet për rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së ish-punonjësit të policisë dhe prononcimin e këtij institucioni se vdekja e ish-punonjësit të strukturave të Policisë së Shtetit ka qenë në krye të detyrës dhe ka ardhur për shkak të detyrës ose jo.
- c) Kur shtetasi shqiptar ka qenë ose është nga shoqëria civile, dhe ka humbur jetën ose që e humbet jetën në përpjekje për të ndihmuar popullsinë në raste të fatkeqësisë natyrore, për mbrojtjen e pronës publike ose për shpëtimin dhe mbrojtjen e jetës së individit nga krimi:**
1. Certifikatë e gjendjes gjyqësore për personin për të cilin kërkohet të shpallet “Dëshmor i atdheut”.
 2. Vërtetim që ka kryer shërbimin ushtarak nga Qendra e Personel-Rekrutimit të Forcave të Armatosura në rastet e shërbimit ushtarak të detyrueshëm.
 3. Dokumente nga arkivi i sistemit të ministrisë përkatëse, të prodhuara nga strukturat e ministrisë dhe strukturat vartëse të saj, në kohën e ngjarjes së humbjes së jetës së shtetasit, për të cilin kërkohet shpallja dëshmor i atdheut, ka humbur jetën ose që e humbjet jetë në përpjekje për të ndihmuar popullsinë në raste të fatkeqësisë natyrore, për mbrojtjen e pronës publike ose për shpëtimin dhe mbrojtjen e jetës së individit nga krimi.
 4. Dokumente nga strukturat e Policisë së Shtetit, të cilat japin të dhëna dhe informacion mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar për të cilin është kërkuar të shpallet “Dëshmor i atdheut”.
 5. Dokumente nga dosja hetimore e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e juridiksionit ku ka ndodhur ngjarja e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar, për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.
 6. Aktekspertiza e vdekjes së shtetasit shqiptar, të lëshuar nga ish-Spitali Qendror Ushtarak, Spitali Universitar i Traumës apo spitali shtetëror rajonal ose Shërbimi i Ekspertizës Mjekoligjore.

7. Vendimi i gjykatës së formës së prerë që jep të dhëna për rrethanat dhe shkaqet e ndarjes nga jeta së shtetasit shqiptar për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.
8. Kur shtetasi shqiptar për të cilin është kërkuar shpallja “Dëshmor i atdheut”, është ish-punonjës i një strukture të një organi shtetëror, duhet një informacion zyrtar nga ky organ (drejtoria e menaxhimit të personelit në ministrinë e fushës), që shprehet për rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së ish-punonjësit të saj, si dhe prononcimi i këtij institucioni se ish-punonjësi i saj ka humbur jetën në përpjekje për të ndihmuar popullsinë në raste të fatkeqësisë natyrore apo për mbrojtjen e pronës publike ose për shpëtimin dhe mbrojtjen e jetës së individit nga krimi.

ç) Kur shtetasi shqiptar është vrarë gjatë tubimeve paqësore dhe pa armë për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose që kanë humbur jetën në krye të detyrës në mbrojtje të procesit zgjedhor pas datës 8 dhjetor 1990:

1. Certifikatë e gjendjes gjyqësore për personin për të cilin kërkohet të shpallet “Dëshmor i atdheut”.
2. Vërtetim që ka kryer shërbimin ushtarak nga Qendra e Personel-Rekrutimit të Forcave të Armatosura në rastet e shërbimit ushtarak të detyrueshëm.
3. Dokument nga strukturat e Policisë së Shtetit, të cilat japin të dhëna dhe informacion mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar për të cilin është kërkuar të shpallet “Dëshmor i atdheut”.
4. Vërtetim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që vërteton se shtetasi shqiptar i propozuar për shpalljen “Dëshmor të atdheut” ka qenë i angazhuar në procesin zgjedhor (ky dokument vetëm për shtetasit që kanë humbur jetën në krye të detyrës në mbrojtje të procesit zgjedhor, pas datës 8 dhjetor 1990).
5. Dokumente nga dosja hetimore e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e juridiksionit ku ka ndodhur ngjarja e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar, për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”, të cilat vërtetojnë se shtetasi është vrarë gjatë tubimeve paqësore dhe pa armë për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose që kanë humbur jetën në krye të detyrës në mbrojtje të procesit zgjedhor, pas datës 8 dhjetor 1990.
6. Aktekspertiza e vdekjes së shtetasit shqiptar, të lëshuar nga ish-Spitali Qendror Ushtarak, Spitali Universitar i Traumës apo spitali shtetëror rajonal ose Shërbimi i Ekspertizës Mjekoligjore.

7. Vendimi i gjykatës së formës së prerë që jep të dhëna për rrethanat dhe shkaqet e ndarjes nga jeta së shtetasit shqiptar për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.

d) Kur shtetasi shqiptar vritet nga forcat apo elementët antishqiptarë në mbrojtje të flamurit, simboleve kombëtare dhe manifestimit të ndjenjave kombëtare:

1. Certifikatë e gjendjes gjyqësore për personin për të cilin kërkohet të shpallet “Dëshmor i atdheut”.
2. Vërtetim që ka kryer shërbimin ushtarak nga Qendra e Personel-Rekrutimit të Forcave të Armatosura në rastet e shërbimit ushtarak të detyrueshëm.
3. Dokumente nga strukturat e përgjegjëse për punët e jashtme, të cilat japin të dhëna mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar jashtë vendit, për të cilin është kërkuar të shpallet “Dëshmor i atdheut”.
4. Dokument nga strukturat e përgjegjëse për punët e jashtme të shtetit të huaj ku ka ndodhur ngjarja (ambasada e shtetit të huaj etj.), të cilat japin të dhëna mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar jashtë vendit, për të cilin është kërkuar të shpallet “Dëshmor i atdheut”.
5. Dokument nga strukturat e Policisë së Shtetit, të cilat japin të dhëna mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar brenda vendit, për të cilin është kërkuar të shpallet “Dëshmor i atdheut”.
6. Dokumente nga dosja hetimore e Prokurorisë së shtetit të huaj ku ka ndodhur ngjarja e vrasjes së shtetasit shqiptar apo Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë që ka juridiksionin, në rast se ka humbur jetën brenda territorit të Shqipërisë.
7. Aktekspertiza e vdekjes së shtetasit shqiptar, të lëshuar nga institucionet policore dhe shëndetësore të shtetit të huaj ku ka ndodhur ngjarja apo kur ngjarja ka ndodhur brenda vendit nga Spitali Universitar i Traumës apo spitali shtetëror rajonal ose Shërbimi i Ekspertizës Mjekoligjore Shqiptare.
8. Vendimi i gjykatës së formës së prerë e shtetit ku ka ndodhur ngjarja që jep të dhëna për rrethanat dhe shkaqet e ndarjes nga jeta së shtetasit shqiptar për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.

KREU V
KOMISIONET VENDORE DHE MËNYRA E PARAQITJES SË KËRKESËS DHE
AFATI I SHQYRTIMIT TË SAJ

Neni 14
Paraqitja e kërkesës dhe regjistrimi

1. Kërkesa për shpalljen “Dëshmor i atdheut”, së bashku me dokumentet me karakter të përgjithshëm dhe dokumentet vërtetuese sipas këtij udhëzimi, paraqiten nëpërmjet portalit e-Albania për shqyrtim pranë këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose prefektit, që ka juridiksion administrativ në territorin ku ka vendbanimin familja e personit, për të cilin kërkohet të shpallet “Dëshmor i atdheut” ose t’i njihet statusi “Dëshmor i atdheut”.
2. Kërkuesi i statusit të dëshmorit të atdheut është një nga subjektet e përcaktuara në nenin 6 të këtij udhëzimi.
3. Rregjistrimi i kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese (të dërguarar nëpërmjet portalit e-Albania) bëhet nga zyra e sekretarisë së këshillit të qarkut, bashkisë apo prefekturës, e cila e regjistron kërkesën në një regjistër të posaçëm, sipas rendit kronologjik të paraqitjes.
4. Përfaqësuesi i subjektit që paraqet kërkesën nëpërmjet portalit e-Albania plotëson dhe firmos formularin përkatës (shtojca 1) sipas këtij udhëzimi, duke bashkëlidhur dokumentacionin vërtetues me të dhëna për adresën e tij dhe inventarin e dokumenteve që paraqet, kur këto nuk i ka kërkesa e tij.
5. Përfaqësuesit të subjektit që paraqet kërkesën dhe dokumentet vërtetuese, në çdo rast, i lëshohet një vërtetim nëpërmjet portalit e-Albania që konfirmon faktin e pranimi të kërkesës, objektin e saj, datën dhe listën e dokumenteve bashkëlidhur, nëse ka të tilla.
6. Zyra e sekretarisë së këshillit të qarkut bashkisë apo e prefekturës, brenda 48 orëve të regjistrimit të kërkesës (së paraqitur nëpërmjet portalit e-Albania), dorëzon dokumentet pranë komisionit vendor për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”.
7. Komisioni vendor i pranimi dhe shqyrtimit të kërkesave për statusin “Dëshmor i atdheut” pranë këshillit të qarkut apo prefekturës, nëse konstaton se dokumentacioni i dërguar ka mangësi, sipas përcaktimit të këtij udhëzimi, njofton nëpërmjet portalit e-Albania për plotësimin e tyre subjektin kërkues, duke i caktuar dhe një afat prej 15-30 ditësh për dërgimin e tyre. Kur subjekti kërkues nuk plotëson dokumentacionin brenda afatit të caktuar, kërkesa quhet se nuk është regjistruar.

Neni 15

Afati i shqyrtimit të kërkesës dhe dërgimi i propozimit

1. Këshilli i qarkut, këshilli bashkiak apo prefekti, brenda **1 muaji** nga relatimi nga komisioni vendor përkatës, shqyrton dokumentacionin e dërguar nga komisioni vendor për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” dhe merr vendim, për t’i propozuar ose jo Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.
2. Kërkesa për shpalljen “Dëshmor i atdheut”, të shtetasit shqiptar ose të huaj, së bashku me dokumentet përkatëse, paraprakisht, duhet të shqyrtohen nga komisioni vendor brenda 1 muaji nga data e regjistrimit të kërkesës, për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” pranë këshillit të qarkut, këshillit bashkiak apo prefekturës.
3. Komisioni vendor pasi shqyrton kërkesën dhe dokumentet vërtetuese të saj dhe e gjen të ligjshme dhe të plotë kërkesën e paraqitur, i relatton këshillit apo prefektit respektiv për të vendosur mbi kërkesën e paraqitur nga subjekti kërkuar.
4. Në mbledhjen e komisionit vendor për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për shpalljen ose njohjen e statusit të “Dëshmori të atdheut” mbahet procesverbal dhe relacioni të cilat firmosen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje dhe këto mbahen në tri kopje, një kopje e së cilës arkivohet në sekretarinë e institucionit, kopja e dytë paraqitet nëpërmjet portalit e-Albania së bashku me propozimin pranë KQSDA-së dhe kopja tjetër administrohet në dosjen e personit.
5. Këshilli i qarkut, këshilli bashkiak apo prefekti, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga komisioni vendor për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” dhe njihet me relacionin dhe mendimin e komisionit vendor merr vendim përfundimtar për t’i propozuar ose jo Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” pranë Ministrisë së Mbrojtjes, për shpalljen “Dëshmor i atdheut” ose njohjen e statusit dëshmor të atdheut të personit objekt të kërkesës së shqyrtuar.
6. Pas marrjes së vendimit për propozim nga këshilli i qarkut, këshilli bashkiak apo prefekti, i shoqëruar me motivacionin përkatës, si dhe dokumentet përkatëse sipas këtij udhëzimi, komisioni vendor plotëson dokumentacionin e nevojshëm dhe e dërgon nëpërmjet portalit e-Albania pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, në Ministrinë e Mbrojtjes.
7. Në rast se këshilli i qarkut, këshilli i bashkisë apo prefekti refuzon kërkesën e paraqitur nga subjekti kërkuar njofton nëpërmjet portalit e-Albania kërkuar.

KREU VI

ORGANET PROPOZUESE PËR STATUSIN E “DËSHMORIT TË ATDHEUT”

Neni 16

Organet (subjektet) propozuese

1. Organi që dërgon propozimet për shpalljen dëshmor të atdheut apo njohjen e statusit dëshmor të atdheut pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” pranë Ministrisë së Mbrojtjes është:
 - Këshilli i qarkut;
 - Këshilli bashkiak;
 - Prefekti i qarkut;
 - Ministri për subjektet nën fushën e tij të përgjegjësisë së tij.
2. Propozimi për shpalljen “Dëshmor të atdheut” apo “njohjen” e statusit dëshmor të atdheut paraqitet nëpërmjet portalit e-Albania në Komisionin Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” pranë Ministrisë së Mbrojtjes nga organi të cilit i është drejtuar kërkesa nga subjekti kërkuar dhe e ka shqyrtuar atë.

KREU VII

DOKUMENTACIONI I PROPOZIMIT QË DËRGOHET PRANË KOMISIONIN QENDROR TË STATUSIT “DËSHMOR I ATDHEUT”

Neni 17

Dokumentacioni që organi propozues paraqet pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”

Këshilli bashkiak, këshilli i qarkut apo prefekti për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” të një personi, paraqet pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” dokumentacionin, si më poshtë:

- a) **Dokumentacioni që paraqet këshillit i qarkut, këshilli bashkiak apo prefekti bashkëlidhur propozimit për shpalljen apo njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”:**
 1. Shkresa përcjellëse me deklarinimin e numrit të dokumenteve që dërgohen.
 2. Vendimi i propozimit të këshillit të qarkut, këshillit bashkiak apo prefektit të shoqëruar me motivacionin përkatës.
 3. Procesverbali i mbledhjes së komisionit vendor dhe relacioni shpjegues i komisionit vendor për shqyrtimin e kërkesave për shpalljen apo njohjen e statusit “Dëshmor i

atdheut” pranë këshillit të qarkut, këshillit bashkiak apo prefektit përkatës, si dhe kërkesa e të interesuarit, së bashku me dokumentet përkatëse të saj.

b) Dokumentacioni që paraqitet nga ministri përkatës drejtpërdrejt në Komisionin Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, në mbështetje të nenit 12, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.

Për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të shtetasit shqiptar dhe të huaj të cilët plotësojnë kriteret në mbështetje të nenit 12, të ligjit nr. 1409/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, ministri përkatës paraqet pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut” në Ministrinë e Mbrojtjes, dokumentet:

i) Kur shtetasi i huaj është pjesëtar i formacioneve në ndihmë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë apo Policisë së Shtetit Shqiptar, të cilët humbin jetën në krye të detyrës, në ndihmë të popullsisë apo në përpjekje kundër terrorizmit ose krimit ndaj jetës individit:

1. Shkresa përcjellëse, me deklarinimin e numrit të dokumenteve që dërgohen.
2. Shkresa e propozimit dhe motivacioni.
3. Certifikata e vdekjes për shtetasin që kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”, të lëshuar nga institucionet përgjegjëse të shtetit amë.
4. Certifikata e përbërjes familjare në çastin e ndarjes nga jeta të shtetasit të huaj, për të cilin kërkohet të shpallet “Dëshmor i atdheut”, të lëshuar nga institucionet përgjegjëse të shtetit amë.
5. Dokument nga strukturat përgjegjëse për punët e jashtme të shtetit të huaj (ambasada e shtetit të huaj etj.), të cilat japin të dhëna mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit të huaj, për të cilin është kërkuar të shpallet “Dëshmor i atdheut”.
6. Dokument nga strukturat e Policisë, të cilat japin të dhëna mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit të huaj brenda vendit, për të cilin është kërkuar të shpallet “Dëshmor i atdheut”.
7. Dokumente nga dosja hetimore e prokurorisë së shtetit shqiptar apo të huaj që japin të dhëna për rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit të huaj, pjesëtar të formacioneve në ndihmë të FA-së apo Policisë së Shtetit Shqiptar.
8. Aktekspertiza e vdekjes e shtetasit të huaj, nga institucionet policore dhe shëndetësore të Shqipërisë (Spitali Universitar i Traumës apo spitali shtetëror rajonal ose Shërbimi i Ekspertizës Mjekoligjore Shqiptare).

9. Dokumente shoqëruese të medaljeve dhe titujve të nderit të dhëna nga institucionet shtetërore shqiptare apo të huaja.
10. Fotografi ose çfarëdo dokumenti me figurë të shtetasit të ndarë nga jeta që kërkohet t'i jepet statusi i "Dëshmor i atdheut".
11. Pas aprovimit të familjes, kërkesën për varrimin e të ndjerit në varrezat e dëshmorëve të atdheut.

ii) Kur shtetasi i huaj, është pjesëtar i formacioneve ushtarake të NATO-s, në ndihmë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që humbet jetën në krye të detyrës, në mbrojtje të integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë:

1. Shkresa përcjellëse, me deklarin e numrit të dokumenteve që dërgohen.
2. Shkresa e propozimit dhe motivacioni.
3. Certifikata e vdekjes për shtetasin që kërkohet shpallja "Dëshmor i atdheut", të lëshuar nga institucionet përgjegjëse të shtetit amë.
4. Certifikata e përbërjes familjare në çastin e ndarjes nga jeta të shtetasit të huaj, për të cilin kërkohet të shpallet "Dëshmor i atdheut", të lëshuar nga institucionet përgjegjëse të shtetit amë.
5. Dokument nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, të cilat japin të dhëna mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit të huaj brenda vendit, për të cilin është kërkuar të shpallet "Dëshmor i atdheut".
6. Dokument nga strukturat e NATO-s dhe strukturat përgjegjëse për punët e jashtme të shtetit amë të shtetasit të huaj (ambasada e shtetit të huaj), të cilat japin të dhëna mbi gjendjen civile dhe familjare, si dhe rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit të huaj, për të cilin është kërkuar të shpallet "Dëshmor i atdheut".
7. Dokumente nga dosja hetimore e Prokurorisë së shtetit shqiptar apo të huaj që japin të dhëna për rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit të huaj pjesëtar të formacioneve ushtarake të NATO-s, në ndihmë të FA-së të Shqipërisë.
8. Aktekspertiza e vdekjes e shtetasit të huaj, të lëshuar nga institucionet policore dhe shëndetësore të Shqipërisë (nga Spitali Universitar i Traumës apo spitali shtetëror rajonal ose Shërbimi i Ekspertizës Mjekoligjore Shqiptare).

9. Dokumente shoqëruese të medaljeve dhe titujve të nderit të dhëna nga institucionet shtetërore shqiptare dhe të huaja.
10. Fotografi ose çfarëdo dokumenti me figurë të shtetasit të ndarë nga jeta që kërkohet t'i jepet statusi i "Dëshmor i atdheut".
11. Pas aprovimit të familjes, kërkesën për varrimin e të ndjerit në varrezat e dëshmorëve të atdheut.

iii) Kur shtetasi shqiptar që bien në krye të detyrës me misione në mbështetje të paqes e të sigurisë së popujve të tjerë:

1. Shkresa përcjellëse me deklarinimin e numrit të dokumenteve që dërgohen.
2. Shkresa e propozimit dhe motivacioni.
3. Certifikata e vdekjes së shtetasit shqiptar për të cilin kërkohet shpallja "Dëshmor i atdheut".
4. Certifikata e përbërjes familjare (trungut familjar) në çastin e ndarjes nga jeta të shtetasit shqiptar, për të cilin kërkohet të shpallet "Dëshmor i atdheut".
5. Certifikata e gjendjes gjyqësore për personin për të cilin kërkohet të shpallet "Dëshmor i atdheut".
6. Dokumente me të dhëna dhe informacion nxjerrë nga regjistrat e rekrutimit, dhe dosjen personale të ushtarakut të arkivuar pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit të Forcave të Armatosura.
7. Dokument nga strukturat përgjegjëse për punët e jashtme, të cilat japin të dhëna mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar jashtë vendit, për të cilin është kërkuar të shpallet "Dëshmor i atdheut".
8. Dokument nga strukturat përgjegjëse për punët e jashtme të shtetit të huaj ku ka ndodhur ngjarja (ambasada e shtetit të huaj), të cilat japin të dhëna mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar jashtë vendit, për të cilin është kërkuar të shpallet "Dëshmor i atdheut".
9. Dokument nga strukturat e Policisë së Shtetit, të cilat japin të dhëna mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar, për të cilin është kërkuar të shpallet "Dëshmor i atdheut".

10. Dokumente nga dosja hetimore e prokurorisë së shtetit të huaj ku ka ndodhur ngjarja e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar, për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.
11. Aktekspertiza e vdekjes së shtetasit shqiptar, të lëshuar nga institucionet policore dhe shëndetësore të shtetit të huaj ku ka ndodhur ngjarja.
12. Vendimi i gjykatës së formës së prerë e shtetit ku ka ndodhur ngjarja që jep të dhëna për rrethanat dhe shkaqet e ndarjes nga jeta së shtetasit shqiptar për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.
13. Dokumenteve shoqëruese të medaljeve dhe titujve të nderit të dhëna nga institucionet shtetërore shqiptare.
14. Fotografi ose çfarëdo dokumenti me figurë të shtetasit të ndarë nga jeta që kërkohet t’i jepet statusi i “Dëshmor i atdheut”.
15. Pas aprovimit të familjes, kërkesën për varrimin e të ndjerit në varrezat e dëshmorëve të atdheut.

KREU VIII

VARRIMI DHE RIVARRIMI I MBETJEVE MORTORE TË DËSHMORIT TË ATDHEUT, SUBJEKTET KËRKUESE DHE DOKUMENTACIONI QË PARAQITET PRANË ORGANEVE VENDIMMARRËSE

Neni 18

Organet kërkuese dhe vendimmarrëse për varrimet dhe rivarrimet e mbetjeve mortore të dëshmorëve të atdheut në varrezat e dëshmorëve të atdheut në kryeqytet dhe në qarqet përkatëse

1. Në shenjë nderimi, përkujtimi dhe mirënjohje kombëtare për dëshmorët e atdheut janë ndërtuar varrezat ku prehen dëshmorët e atdheut, të cilat administrohen nga bashkitë përkatëse.
2. Çdo dëshmor ka një varr në varrezat e dëshmorëve të atdheut, të ngritura në territorin e qarkut ku ka rënë ose ka pasur vendbanimin, me përjashtim të atyre që prehen në varrezat e dëshmorëve të atdheut “Nëna Shqipëri” në kryeqytet, ku prehen dëshmorë që përfaqësojnë qarqet e Shqipërisë.
3. Varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimin i mbetjeve mortore të tij në varrezën e dëshmorëve të atdheut “Nëna Shqipëri”, në kryeqytet bëhet me vendim të Komisionit

Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, bazuar në kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të dërguara nga këshillit bashkiak, këshilli i qarkut, prefekti ose ministri e paraqitur nëpërmjet portalit e-Albania pranë KQSDA-së.

4. Varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimi i tij në varrezat e dëshmorëve të atdheut në qarqet përkatëse bëhet me vendim të këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose të prefektit, bazuar nga kërkesa e familjes së dëshmorit të atdheut apo drejtuesit e institucioneve të shtetit e paraqitur nëpërmjet portalit e-Albania, duke marrë më parë miratimin e gjithë pjesëtarëve të rrethit të ngushtë të familjes së dëshmorit të atdheut.

Neni 19

Dokumentacioni që paraqitet nga organet shtetërore pranë KQSDA-së për varrimin apo rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut në varrezën e dëshmorëve të atdheut “Nëna Shqipëri”, në kryeqytet

1. Kërkesa e cila i është drejtuar KQSDA-së nëpërmjet portalit e-Albania nga këshillit bashkiak, këshilli i qarkut, prefekti ose ministri përkatës për varrimin apo rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut në varrezën e dëshmorëve të atdheut “Nëna Shqipëri”.
2. Kërkesa sipas formatit (shtojca 2) e cila i është drejtuar nëpërmjet portalit e-Albania këshillit bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit të qarkut, nga përfaqësuesi i autorizuar nga pjesëtarët e tjerë të familjes së dëshmorit të atdheut, për varrosjen apo rivarrosjen e mbetjeve mortore të tij në varrezat e dëshmorëve të atdheut “Nëna Shqipëri”.
3. Mjeti identifikues i subjektit kërkues, të autorizuar nga pjesëtarët e rrethit të ngushtë familjar të dëshmorit të atdheut.
4. Prokurë e posaçme apo deklaram noterial, që vërteton se subjekti kërkues është autorizuar nga pjesëtarët e tjerë të familjes së dëshmorit të atdheut për ndjekjen e procedurave për varrimin apo rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit në varrezën e dëshmorëve të atdheut.
5. Certifikata e vdekjes së dëshmorit të atdheut, lëshuar nga zyra e gjendjes civile në juridiksionin e vendbanimit që ka pasur dëshmori para ndarjes nga jeta.
6. Certifikata e përbërjes familjare (trungut) e dëshmorit të atdheut në çastin e ndarjes nga jeta të tij.
7. Certifikatë familjare që vërteton lidhjen familjare të subjektit kërkues me dëshmorin e atdheut për të cilin kërkohet varrimi apo rivarrimi i tij në varrezën e dëshmorëve të atdheut.

8. Kopja e vendimit të shpalljes “Dëshmor i atdheut” të personit apo vendimi i njohjes së statusit “Dëshmor i atdheut” të tij nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”.
9. Vërtetim nga strukturat e bashkisë së kryeqytetit që konfirmohet se në varrezën e dëshmorëve të atdheut “Nëna Shqipëri” ka vende të lira në parcelën përkatëse për rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut.
10. Dokumenti i cili vërteton se fondet monetare përkatëse, për zhvarrimin nga varrezat publike dhe rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut, si dhe ato për transportin dhe kurorat janë të siguruara nga organi kërkues.

Neni 20

Dokumentacioni që paraqitet nga subjektet kërkuese (familjet e dëshmorëve të atdheut) pranë këshillit të bashkisë, këshillit të qarkut apo prefektit për varrimin apo rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut në varrezën e dëshmorëve të atdheut në qarkut përkatës

1. Kërkesa nëpërmjet portalit e-Albania sipas formatit (shtojca 2) drejtuar këshillit bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit të qarkut, nga përfaqësuesi i autorizuar nga pjesëtarët e tjerë të familjes së dëshmorit të atdheut, për varrosjen apo rivarrosjen e mbetjeve mortore të tij në varrezën e dëshmorëve të qarkut përkatës.
2. Mjeti identifikues i subjektit kërkues, të autorizuar nga pjesëtarët e rrethit të ngushtë familjar të dëshmorit të atdheut.
3. Prokurë e posaçme apo deklaram noterial, që vërteton se subjekti kërkues është autorizuar nga pjesëtarët e tjerë të familjes së dëshmorit të atdheut për ndjekjen e procedurave për varrimin apo rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit në varrezën e dëshmorëve të atdheut.
4. Certifikata e vdekjes së dëshmorit të atdheut, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në juridiksionin e vendbanimit që ka pasur dëshmori para ndarjes nga jeta.
5. Certifikata e përbërjes familjare (trungut) e dëshmorit të atdheut në çastin e ndarjes nga jeta të tij.
6. Certifikatë familjare që vërteton lidhjen familjare të subjektit kërkues me dëshmorin e atdheut për të cilin kërkohet varrimi apo rivarrimi i tij në varrezën e dëshmorëve të atdheut.
7. Fotokopje e vendimit të shpalljes “Dëshmor të atdheut” të personit apo e vendimit të njohjes së statusit “Dëshmor i atdheut” të tij nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

8. Vërtetim nga strukturat e bashkisë që konfirmohet se në varrezat e dëshmorëve të atdheut në qarkun përkatës ka vende të lira në parcelën përkatëse për rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut.
9. Dokumenti i cili vërteton se fondet monetare përkatëse për zhvarrimin nga varrezat publike dhe rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut, si dhe ato për transportin dhe kurorat janë të siguruara nga subjekti kërkues.

KREU IX

E DREJTA E ANKIMIMIT DHE DOKUMENTET QË DORËZOHEN

Neni 21

Ankimi

1. Kundër vendimit të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit që refuzon të pranojë kërkesën për statusin e dëshmorit të atdheut ose kur këto organe nuk marrin në shqyrtim kërkesën brenda afateve të parashikuara nga ligji nr.109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut” (2 muaj), subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim nëpërmjet portalit e-Albania pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, brenda 30 ditëve nga marrja në dijeni për refuzimin e kërkesës apo nga data e mbarimit të afatit ligjor në shqyrtimin e kërkesës.
2. Kundër vendimit të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, si dhe në rastet kur ky komision nuk shprehet brenda afateve të përcaktuara në pikën 6, të nenit 10, të ligjit nr.109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim pranë gjykatës kompetente, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 22

Dokumentet që paraqiten nga ankuesi pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”

- a) Dokumentet që paraqiten nëpërmjet portalit e-Albania nga ankuesi pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” kundër vendimit të këshillit të bashkiak, këshilli të qarkut apo prefekti të qarkut janë, si më poshtë:
 1. Kërkesë-ankesa, sipas formularit (shtojca 3), bashkëlidhur këtij udhëzimi.
 2. Certifikata personale ose fotokopje të kartës së identitetit, të firmosur nga ankuesi.

3. Dokumenti origjinal (ose i noterizuar) të autorizimit të përfaqësimit, të lëshuar nga pjesëtarët e familjes së personit për të cilin kërkohet të shpallet ose t'i njohet statusi "Dëshmor i atdheut".
4. Kopje e vendimit për mospranimin e kërkesës të organit ku ishte drejtuar kërkesa për statusin e dëshmorit të atdheut.
5. Dokumenti që vërteton datën e marrjes së njoftimit nëpërmjet portalit e-Albania për vendimin përfundimtar të organit ku ishte drejtuar kërkesa për statusin e dëshmorit të atdheut (këshilli i qarkut, këshilli bashkiak apo prefekti).
6. Shkresa zyrtare e njoftimit nëpërmjet portalit e-Albania nga këshilli i qarkut, këshilli bashkiak apo prefektit të dërguar në adresën e subjektit kërkues, ku e njofton për aktin administrativ të tij.
7. Kopje të kërkesës drejtuar organit përkatës (këshilli i qarkut, këshilli bashkiak apo prefekti), për shpalljen "Dëshmor i atdheut" të personit objekt të kërkesës.
8. Dokumentet bashkëlidhur formatit të kërkesës (shtojca nr. 1), drejtuar organit përkatës (këshilli i qarkut, këshilli bashkiak apo prefekti).

b) Dokumentet që paraqiten nëpërmjet portalit e-Albania nga ankuesi pranë Komisionit Qendror të Statusit "Dëshmor i Atdheut" kundër këshillit të qarkut, këshillit të bashkisë apo prefektit, kur këto organe nuk marrin në shqyrtim kërkesën brenda afateve ligjore:

1. Kërkesë-ankesa sipas formularit (shtojca 3). bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Certifikata personale ose fotokopje të kartës së identitetit, të firmosur nga ankuesi.
3. Dokumenti origjinal (ose i noterizuar) të autorizimit të përfaqësimit, të lëshuar nga pjesëtarët e familjes së personit për të cilin kërkohet të shpallet ose t'i njohet statusi i dëshmorit të atdheut.
4. Kopje e kërkesës (shtojca nr. 1), drejtuar organit përkatës (këshilli i qarkut, këshilli bashkiak apo prefekti).
5. Kopje origjinale e dokumentit (vërtetim), të lëshuar nëpërmjet portalit e-Albania nga sekretaria e organit ku ishte drejtuar kërkesa (këshillit të qarkut, këshillit bashkiak apo prefektit), që konfirmon faktin e pranimin të kërkesës, objektin e saj, datën dhe listën e dokumenteve bashkëlidhur kërkesës, nëse ka pasuar të tilla.

6. Kopje e ankesës administrative drejtuar këshillit të qarkut, këshillit bashkiak apo prefektit, për arsyen e mosmarrjes në shqyrtim brenda afatit ligjor të kërkesës drejtuar këtyre organeve.
7. Kopje e shkresës e lëshuar nëpërmjet portalit e-Albania së përgjigjes nga organi përkatës në lidhje me ankesën administrative drejtuar organit.
8. Dokumente shoqëruese bashkëlidhur formatit të kërkesës (shtojca nr.1). drejtuar organit përkatës (këshilli i qarkut, këshilli bashkiak apo prefekti).

Neni 23

Dokumentet që kërkohen për kryerjen e hetimit administrativ nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” për zgjidhjen e ankesës administrative drejtuar komisionit

1. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” shqyrton ankesat administrative që paraqiten nga subjektet kërkuuese kundër vendimit të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit, që refuzojnë të pranojnë kërkesën ose kur këto organe nuk marrin në shqyrtim kërkesën brenda afateve të parashikuara nga neni 11, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.
2. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” për shqyrtimin e ankimit dhe zhvillimin e procedurës së hetimit administrativ në lidhje me këtë ankesë, bashkëpunon, me këshillin bashkiak, këshillin e qarkut apo prefektin (komisionet vendore respektive), duke kërkuar prej tyre nëpërmjet portalit e-Albania informacion dhe dokumente për procedurat e kryera.
3. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” për shqyrtimin e ankimit dhe zhvillimin e procedurës së hetimit administrativ në lidhje me këtë ankesë kërkon nga këshilli i bashkisë, këshilli i qarkut apo prefekti që është objekt i ankesës, informacionin dhe dokumentet, si më poshtë:

a) informacion me të dhëna për:

- numrin dhe datën e depozitimit (regjistrimit) të kërkesës nëpërmjet portalit e-Albania;
- përmbajtjen e kërkesës me të cilën subjekti kërkuar i është drejtuar organit;
- listën dhe llojin e dokumenteve të paraqitura bashkëlidhur kërkesës;
- datën e marrjes në shqyrtim e kërkesës nga komisioni vendor për shqyrtimin e kërkesave për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”;
- një përmbledhje e shkurtër e relacionit (vendimit) të përgatitur nga komisioni vendor, në lidhje me kërkesën për shpalljen “Dëshmor të atdheut” të personit, që i është paraqitur organit epror për marrje vendimi përfundimtar;

- datën e marrjes në shqyrtim nga organi epror, pas relatimit nga komisioni vendor;
- numrin, datën e miratimit, si dhe formë e aktit administrativ (vendimit) të miratuar nga organi epror;
- një përmbledhje të shkurtër nga arsyetimi që është përfshirë në formën e shkruar të vendimit të organit epror apo në procesverbalin e mbledhjes së këtij organi (në lidhje me refuzimin e mosdërgimit për trajtim të propozimit pranë KQADA-së;
- datën e nisjes së njoftimit për subjektin kërkues, në lidhje me vendimin përfundimtar të organit që mori në shqyrtim kërkesën në lidhje me kërkesën.

b) Dokumentet shoqëruese që kërkohen bashkëlidhur informacionit:

- i) Kopje të kërkesës së subjektit kërkues, dërguar nëpërmjet portalit e-Albania pranë këshillit të qarkut, këshillit bashkiak apo prefektit.
- ii) Kopje të njësuar me origjinalin të të gjitha dokumenteve bashkëlidhur kërkesës së subjektit kërkues të paraqitura pranë këshillit të qarkut, këshillit bashkiak apo prefektit.
- iii) Kopje e relacionit të komisioni vendor, që i është paraqitur këshillit të qarkut, këshillit të bashkisë apo prefektit, në lidhje me kërkesën e paraqitur për statusin e dëshmorit të atdheut.
- iv) Kopje e vendimit të këshillit të qarkut, këshillit të bashkisë apo prefektit për refuzimin e dërgimit për trajtim pranë KQSDA-së të propozimit për shpalljen “Dëshmor të atdheut” të personit objekt të kërkesës.
- v) Kopje të shkresës së njoftimit të subjektit kërkues për vendimin përfundimtar të këshillit të qarkut, këshilli bashkiak apo prefektit për mospranimin e kërkesës së drejtuar organit, për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të personit objekt të kërkesës.

KREU X

**KUSHTET TEKNIKE TË PLOTËSIMIT TË DOKUMENTEVE DHE PËRCAKTIMI
JURIDIK I VLEFSHMËRISË SË TYRE**

Neni 24

Kushtet teknike të plotësimit të dokumenteve

1. Dokumentet e paraqitura për statusin e dëshmorit të atdheut duhet të plotësojnë këto kushte teknike:
 - të jenë të firmosura nga titullari i institucionit ose personi i autorizimin nga titullari;
 - të jenë të vulosura me vulën e institucionit që e ka lëshuar;
 - të kenë të shënuar numrin e protokollit dhe datën e lëshimit;
 - të mos kenë asnjë lloj korrigjimi;

- emri, atësia dhe mbiemri i të rënit (dëshmorit të atdheut) duhet të përputhet gërmë për gërmë me atë të dokumentit identifikues të gjendjes civile.
2. Kërkesa e paraqitur nga subjekti kërkues duhet të plotësojë kërkesat dhe kriteret e përcaktuar në nenin 7 të këtij udhëzimi.
 3. Kërkesa për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” duhet të përmbajë: emrin, atësinë, mbiemrin, numrin personal të identifikimit (IP), adresa e saktë dhe e plotë e vendbanimit apo e zyrës së punës, si dhe numri i kontaktit (telefon, celular, email-i etj.) i subjektit kërkues; identitetin e plotë dhe të saktë (emër, atësi, mbiemër, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin) të personit që është objekt i kërkesës; jetëshkrimi i tij (arsimimin, gjendja civile, veprimtaria shoqërore, formacionin luftarak apo strukturën shtetërore apo private ku ka punuar), përshkrimin e saktë të rrethanave të ngjarjes, si dhe vendin dhe datën kur ka humbur jetën personi për të cilin kërkohet dhënia apo njohja e statusit “Dëshmor i atdheut”, sipas dokumenteve zyrtare shtetërore dhe çdo dokumentacion tjetër, të përcaktuar në këtë udhëzim.
 4. Kur kërkesa ka si objekt njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” të një personi të shpallur “dëshmor” nga organet shtetërore, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04. 2000 “Statusi i dëshmorit të atdheut”, të shfuqizuar, në formatin e kërkesës së plotësuar prej tyre sipas formatit (shtojca 1), bashkëlidhur këtij udhëzimi, përveç kërkesave të përshkruara në pikën 3, të nenit 26 të këtij udhëzimi, shënohen numri dhe data e vendimit apo dekretit të shpalljes “dëshmor”, si dhe emërtesa e organit shtetëror të mëparshëm që e ka shpallur vendimin.
 5. Dokumentet e lëshuara nga institucionet arkivore dhe institucionet e ruajtjes së kujtesës (muzetë) detyrimisht duhet të përmbajnë referencat e regjistrimit, si:
 - të jenë të vulosura qartë më vulën e institucionit që e ka lëshuar;
 - të kenë të shënuar qartë numrin e protokollit dhe datën e lëshimit;
 - numri i fondit;
 - numri i dosjes;
 - numri i fletëve;
 - viti i dokumentit;
 - lloji i dokumentit.
 6. Në raste kur arkivat lëshojnë vërtetime për dokumentet arkivore që administrojnë, nuk u lejohet të bëjnë interpretime të dokumenteve arkivore, por vetëm të citojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dokumentin, duke vendosur në fund referencat e burimeve arkivore, si në paragrafin e mësipërm.
 7. Dokumentet mund të jenë të lëshuara nga portali “e-Albania” ose të nënshkruara dhe vulosura sipas legjislacionit në fuqi.

8. Çdo propozim për shpalljen “Dëshmor i atdheut” do të shoqërohet me motivacionin përkatës sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 5, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, i cili duhet të përmbajë: emrin, atësinë, mëmësinë, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin, strukturën shtetërore apo shoqërore ku ai ka kryer aktivitetin, vendin, kohën dhe rrethanat e humbjes së jetës, si dhe qëllimi për të cilin ka rënë.
9. Të gjithë dokumentet që paraqiten pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” duhet të jenë fotokopje të noterizuara apo të njësuara me origjinalin.
10. Të gjithë dokumentet e marra nga institucionet e shteteve të huaja duhet të jenë të përkthyer, të noterizuara dhe me vulën apostile, sipas ligjeve në fuqi.
11. Në të gjitha rastet që organet zyrtare nuk disponojnë dokumentet e kërkuara sipas këtij udhëzimi, subjekti kërkues duhet të paraqesë vërtetimin negativ.
12. Shojca nr. 1, shtojca nr. 2 dhe shtojca nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi gjendet nëpërmjet portalit e-Albania.
13. Subjektet propozuese sigurojnë dokumentet e poshtëshënuara nëpërmjet ndërveprimit ndërinstitucional:
 - a. Certifikatë vdekjeje ose “certifikatë negative” të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, në juridiksionin territorial të vendbanimit të përhershëm të personit apo shtetasit shqiptar për të cilin kërkohet shpallja ose njohja e Statusit “Dëshmor i atdheut” dhe në rastin e personit apo shtetasit të huaj, certifikatë vdekjeje nga institucionet përgjegjëse të shtetit amë.
 - b. Certifikatë e përbërjes familjare (trungut familjar) në çastin e ndarjes nga jeta të personit apo shtetasit shqiptar për të cilin kërkohet shpallja ose njohja e Statusit “Dëshmor i atdheut”.
 - c. Certifikatë familjare që vërteton lidhjen familjare të subjektit kërkues me personin objekt të kërkesës.
 - ç. Vërtetim nga institucionet përgjegjëse për vendin e varrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë për shtetasin shqiptar dhe të huaj objekt të kërkesës.
 - d. Certifikata e gjendjes gjyqësore e shtetasit shqiptar që kërkohet shpallja ose njohja e Statusit “Dëshmor i atdheut”.
 - dh. Kopja e vendimit të shpalljes “Dëshmor i atdheut” të personit apo vendimi i njohjes së statusit “Dëshmor i atdheut” të tij nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”.
 - e. Vërtetim nga strukturat e bashkisë së kryeqytetit që konfirmohet se në varrezën e dëshmorëve të atdheut “Nëna Shqipëri” ka vende të lira në parcelën përkatëse për rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut.
 - ë. Vërtetim nga strukturat e bashkisë që konfirmohet se në varrezat e dëshmorëve të atdheut në qarkun përkatës ka vende të lira në parcelën përkatëse për rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut.

- f. Vërtetim që ka kryer shërbimin ushtarak nga Qendra e Personel-Rekrutimit të Forcave të Armatosura në rastet e shërbimit ushtarak të detyrueshëm.
- g. Vërtetimet dhe dokumentet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, arkivat e sistemit, si dhe nga arkivat e institucioneve qendrore dhe vendore.
- gj. Vërtetimet nga strukturat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
- h. Dokumentet me të dhëna dhe informacion që ndodhen në regjistrat e rekrutimit dhe në dosjet personale të ish-ushtarakut/punonjësit civil, të arkivuar pranë Qendrës Personel-Rekrutimit të Forcave të Armatosura.
- i. Dokumentet nga Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura të prodhuara nga strukturat e Forcave të Armatosura (komanda e ish-repartit ushtarak, drejtoritë e Shtabit të Përgjithshëm i FA-së dhe ministrisë së Mbrojtjes, strukturave të Policisë Ushtarake, SHIU, etj), në kohën e humbjes së jetës së ish-ushtarakut/punonjësit civil, për të cilin kërkohet shpallja dëshmor i atdheut.
- j. Dokumenti nga Ministria e Mbrojtjes apo Shtabi i Përgjithshëm, që shprehet për rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së ish ushtarakut dhe prononcimin e këtij institucioni se vdekja e ish-ushtarakut apo punonjësit civil, ka qenë në krye të detyrës dhe ka ardhur për shkak të detyrës ose jo.
- k. Dokumente dhe informacione të nxjerra nga dosja personale e ish-ushtarakut/punonjësit civil, të arkivuar pranë Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme.
- l. Dokumente nga arkivi i sistemit të Ministrisë së Brendshme, të arkivuara në kohën e humbjes së jetës së ish-punonjësit të Policisë së Shtetit.
- ll. Dokumente nga dosja hetimore e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e juridiksionit ku ka ndodhur ngjarja e humbjes së jetës së ish-punonjësit të Policisë së Shtetit, për të cilin kërkohet shpallja “Dëshmor i atdheut”.
- m. Dokument nga Drejtoria e Menaxhimit të Personelit në Ministrinë e Brendshme që shprehet për rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së ish-punonjësit të policisë dhe prononcimin e këtij institucioni se vdekja e ish-punonjësit të strukturave të Policisë së Shtetit ka qenë në krye të detyrës dhe ka ardhur për shkak të detyrës ose jo.
- n. Dokumente nga strukturat e Policisë së Shtetit, të cilat japin të dhëna dhe informacion mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar për të cilin është kërkuar të shpallet “Dëshmor i atdheut”
- nj. Vërtetim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që vërteton se shtetasi shqiptar i propozuar për shpalljen “Dëshmor të atdheut” ka qenë i angazhuar në procesin zgjedhor (ky dokument vetëm për shtetasit që kanë humbur jetën në krye të detyrës në mbrojtje të procesit zgjedhor, pas datës 8 dhjetor 1990).
- o. Dokumente nga strukturat përgjegjëse për punët e jashtme, të cilat japin të dhëna mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së shtetasit shqiptar jashtë vendit, për të cilin është kërkuar të shpallet “Dëshmor i atdheut”.

Neni 25

Përcaktimi juridik i vlefshmërisë së dokumenteve

Përcaktimi juridik i vlefshmërisë së çdo dokumenti zyrtar me burime arkivore të referuara qartë, është kompetencë e komisioneve vendore për shqyrtimin e kërkesave për shpalljen apo njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” dhe e Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

KREU XI

AKTET LIGJORE DHE NËNLIGJORE PËR STATUSIN “DËSHMOR I ATDHEUT”

Neni 26

Aktet ligjore e nënligjore për statusin “Dëshmor i atdheut”.

Aktet ligjore e nënligjore për statusin “Dëshmor i atdheut” që mund të ndihmojnë në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji për statusin e dëshmorit të atdheut janë:

- Ligji nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.
- Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organizimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.
- Ligji nr. 9220, datë 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, të ndryshuar.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 11.12.2019 “Për përbërjen dhe rregullat e detajuara për organizimin, funksionimin e shpërblimit financiar të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 11.12.2019 “Për përcaktimin e kritereve dhe të masës së shpërblimit financiar mujor të familjeve të dëshmorëve të atdheut”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 11.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e varrezave të dëshmorëve të atdheut”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 11.12.2019 “Për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit”, të ndryshuar.
- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave “Normat Tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”;

- Udhëzimi nr. 3912, datë 21.06.2004 “Mbi procedurat për përballimin nga shteti të shpenzimeve të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit”.
- Udhëzimi nr. 16, datë 18.04.2008 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.721, datë 30.10.2007 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 426, datë 09.07.1998, të Këshillit të Ministrave, për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit”, të ndryshuar.
- Vendimi i Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” “Për procedurat e organizimit të ceremonisë së dorëzimit të certifikatës dhe të simboleve të dëshmorit të atdheut, si dhe forma dhe përmbajtja e tyre”.

KREU XII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 27

Shfuqizime

Udhëzimi nr. 1303, datë 10.06.2002 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.151, datë 25.04.2002 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Procedurat e aplikimit sipas këtij udhëzimi hyjnë në fuqi në momentin që Sistemi elektronik dhe shërbimi online do të jenë të implementuar dhe funksionalë.

KRYETARI

MINISTRI I MBROJTJES

Niko Peleshi

